

## KONTRATË SHITJE KUOTE

Sot, me date 01.11.2019, ditë e premte, pasi Asmbleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë me vendimin nr. 6, datë 01.11.2019, miratoi me unanimitet lejimin e shitjes së kuotës si më poshtë përshkruhet, ne palët vendosëm në vullnetin tonë të lirë të përpilojmë këtë kontratë SHITJE mbi kuotën së shoqërisë CRTISTIAN MARINE DURRËS” Sh.P.K., si më poshte vijon:

### Subjektet:

- Shitësi:** Z. Gennaro Canterini, atësia Michele, shtetas italian, lindur në Napoli (NA) më datë 24 gusht\*1974 dhe banues në Napoli, rr. "Ernesto Cesaro", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportë nr.YA1033829, lëshuar më datë 07 shtator 2010, datë skadimi 06 shtator 2020;
- Blerësit:** 1. Z. Fabio Amabile, i biri i Giuseppe -it, lindur më 22.07.1975 në Napoli (NA) dhe banues në Napoli, rr. "Euclide" 47 p.TE, shtetas italian, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti nr. AZ 1378158, të lëshuar nga autoritetet e shtetit italian më datë 29.04.2019, datë skadimi 22.07.2029;

**Objekti dhe qëllimi i kontratës:** Kalimi i pronësisë mbi 22.5 % të kuotës nga 100% e kuotës që disponon z. Gennaro Canterini në shoqërinë “CRTISTIAN MARINE DURRËS” Sh.P.K., NIPT/NUIS L82323506S, regjistruar ne QKR më datë 23.11.2018, me seli në Durrës, lagjja nr. 14, Shkozet, në favor të blerësit Fabio Amabile si më poshtë:

- 1) 22.5 % e kuotës në pronësi të z. Gennaro Canterini, do t'i shitet për vlerën nominale 22.500 lekë z. Fabio Amabile, atësia Giuseppe, i lindur më 22.07.1975 në Napoli, shtetas italian, banues në Napoli, rr. Euclide, nr.47;
1. Përshkak të shitjes kapitali i shoqërisë do të ndahet në tre (3) kuota dhe konkretisht:
  - 1) Fabio Amabile, zotërues i një (1) kuote qe perkon me 45 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 45.000 Leke
  - 2) Roland Marku, zotërues i një (1) kuote që perkon me 20 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 20.000 Leke
  - 3) Gzim Sallilari, zotërues i një (1) kuote qe perkon me 35 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 35.000 Leke.

### Baza ligjore:

Neni 761 e vijues i Kodit Civil te Republikes se Shqiperise;  
Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;  
Aktet nenligjore ne zbatim.

**Shitësi Gennaro Canterini, në cilësinë e ortakut të shoqërisë CRTISTIAN MARINE DURRËS Sh.P.K.**, me nënshkrimin e kësaj kontrate, konfirmon se në cilësinë e pronarit/shitësit të kuotës objekt kontrate, shfaq vullnetin e tij të lirë dhe të plotë që pronësia mbi kuotën që perkon me 22.5 % të kuotës në kapitalin e shoqërisë CRTISTIAN MARINE DURRËS Sh.P.K. dhe për rrjedhojë edhe pronësia kuotën takuese të tij në shoqërine dhe të gjitha të drejtat e tij mbi të gjitha



asetet dhe pasuritë në pronësi të shoqërisë **CRTISTIAN MARINE DURRËS** Sh.P.K t'i kalojë (t'ia shesë) në mënyrë përfundimtare blerësit si më poshtë vijon:

1. 22.5 % e kuotës, do t'i shitet për vlerën nominale 22.500 lekë **z. Fabio Amabile**;

Me nënshkrimin e kesaj kontrate pala shitëse zhvishet në mënyrë përfundimtare nga të drejtat e pronësisë mbi kuotën 22.5 % objekt i kësaj kontrate.

**Blerësi Fabio Amabile**, me nënshkrimin e kësaj kontrate konfirmon se shfaq vullnetin e tij të lirë dhe të plotë për të fituar pronësinë mbi kuotën që përkon me 22.5 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, siç është përcaktuar në këtë kontratë, të shoqërisë **CRTISTIAN MARINE DURRËS** Sh.P.K.. Së bashku me të drejtat që u pershkruan më sipër blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate konfirmon se pranon të marrë përsipër të gjitha detyrimet e shoqërisë **CRTISTIAN MARINE DURRËS** Sh.P.K siç janë në datën e sotme dhe në porpocion me kuotën objekt kontrate. Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala blerëse fiton në mënyrë përfundimtare të gjitha të drejtat mbi shoqërinë *porpocionalisht me kuotën objekt i kesaj kontrate dhe në këtë mënyrë, për shkak të kësaj kontrate kapitali themeltar i shoqërisë Cristian Marinë Durrës Sh.P.K., do të shpërndahet në bashkëpronësi të ortakëve si më poshtë:*

Palet kanë rene dakord qe bashkepronësia qe do te krijohet ne shoqerise si pasoje e kesaj kontrate dhe per rrjedhoje ndryshimi i kapitaleve te shoqerise do pasqyrohet si me poshte vijon:

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë "**CRISTIAN MARINE DURRËS**" Sh.P.K. është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital do të ndahet në 3 (tre) kuota.

Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre dhe do të shpërndahet si më poshtë:

- 1) **Fabio Amabile**, zotërues i një (1) kuote qe perkon me 45 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 45.000 Leke
- 2) **Roland Marku**, zotërues i një (1) kuote qe perkon me 20 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 20.000 Leke
- 3) **Gzim Sallilari**, zotërues i një (1) kuote qe perkon me 35 % të kapitalit themeltare, me vlerë të përgjithshme: 35.000 Leke.

Palët, deklarojnë në vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë se kjo kontratë është hartuar dhe nënshkruar prej tyre duke qenë të vetëdijshëm me pasojat dhe efektet juridike që krijon ky veprim juridik.

Kjo marrëdhënie juridike do të rregullohet bazuar në legjislacionin shqiptar.

Kontrata u hartua ne 4 kopje origjinale dhe do të regjistrohet në regjistrat përkatës në zbatim të legjislacionit mbi të cilin zhvillohet kjo marrëdhënie juridike.

### PALËT KONTRAKTORE

#### SHITËSI

1. **Gennaro Canterini**

Canterini Gennaro

#### BLERËSI

1. **Fabio Amabile**

Amabile Fabio

Në cilësinë e përkthyeses ligjore:

1. **Dalina Bucaj (Teferiçi)**

Dalina Bucaj Teferiçi

